

**STATUTI
I SHOQËRISË "LIRA CREDIT" SH.P.K**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;

Sot, në Tiranë, me datë 25.11.2022, Ortakët e poshtëshënuar themeluan Shoqërinë "LIRA CREDIT" Sh.p.k, e cila do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

Ortakët e shoqërisë janë:

1. Z. **Fatlind BARDHI**, lindur më 26.01.1988, në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I80126033K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Z. **Zaim BARDHI**, lindur më 25.04.1977, në Tropojë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal H70425183O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
3. Z. **Orgest HABILAJ**, lindur më 23.03.1989, në Vlorë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I90323085H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
4. Z. **Florian NANAGJOKA**, lindur më 22.11.1982, në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I21122036K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**


Neni 1

Themeli, Forma dhe Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Krijohet Shoqëria "LIRA CREDIT" Sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3 Shoqëria do të paraqitet me emërtimin tregtar "LIRA CREDIT" Sh.p.k. Ky emërtim do të jetë i vetmi që do të përdoret nga shoqëria në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.4 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.5 Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuase, në formën e caktuar nga Ortakët e shoqërisë.

Neni 2
Themeluesit

- 4.1 Shoqëria është themeluar nga Ortakët e poshtëshënuar:

1. Z. **Fatlind BARDHI**; 
2. Z. **Zaim BARDHI**; 
3. Z. **Orgest HABILAJ**; 
4. Z. **Florian NANAGJOKA**. 

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do të jetë:

"Ushtimi i aktivitetit institucion financiar i mikro kredisë si dhe shërbime këshilluese për veprimtarinë e kredidhënies, si dhe blerje të kredive të portofoleve mikro kredi me vonesë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Objekti i Shoqërisë do të përfshijë dhënien e shërbimeve këshilluese dhe shërbime të tjera ndihmëse për aktivitetin kryesor, sipas parashikimeve të ligjit. Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare, në përputhje licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Shoqëria mund të themelojë apo zotërojë pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare, apo të bashkëpunojë, të lidh marrëveshje joint - venture ose marrëveshje të ngashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngashëm apo të lidhur me objektin e Shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, transaksione me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të garantojë detyrimet e veta apo ato të palëve të treta duke vendosur mbi pasuritë e saj garanci të ndryshme sipas parashikimeve ligjore."

- 3.2 Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, si brenda dhe jashtë vendit.
- 3.3 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Selia e shoqërisë dhe degët

- 4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Njësia Administrative Nr. 3, Rruga "Sitki Cico", Nr. 1, Tiranë.
- 4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjeter bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.
- 4.4 Zyrat, filialat, degët apo agjensitë krijuhen me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë, të cilët organizojnë punën dhe emërojnë organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

- 5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë "LIRA CREDIT" Sh.p.k është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
- 5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakëve të shoqërisë.
- 5.3 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të ortakëve të shoqërisë.

**KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR**

Neni 6
Kapitali Themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **15,000,000 lek (pesëmbëdhjetëmillion lekë)** dhe përbëhet nga **4 (katër) kuota**. Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:

- **Z. Fatlind BARDHI**, lindur më 26.01.1988, në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I80126033K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **zotëruesh i 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 9,000,000 lek (nëntëmillion lek)**, që përfaqëson **60% (gjashtëdhjetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.
- **Z. Zaim BARDHI**, lindur më 25.04.1977, në Tropojë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal H70425183O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **zotëruesh i 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 3,000,000 lek (tremlion lek)**, që përfaqëson **20% (njëzetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.
- **Z. Orgest HABILAJ**, lindur më 23.03.1989, në Vlorë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I90323085H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; **zotëruesh i 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 1,500,000 lek (njëmillion e pesëqindmijë lek)**, që përfaqëson **10% (dhjetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.
- **Z. Florian NANAGJOKA**, lindur më 22.11.1982, në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal I21122036K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; **zotëruesh i 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 1,500,000 lek (njëmillion e pesëqindmijë lek)**, që përfaqëson **10% (dhjetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.

6.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelin e shoqërisë. Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.

6.4 Shoqëria mund të marrë nga ortakët e Shoqërisë hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi, nen perjegjesi te barabarta sipas aksioneve qe perfaqeson dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.5 Adresat e ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse do të ketë më vonë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
- 7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.
- 8.4 Me përashtim të rastit kur me unanimitet ortakët vendosin ndryshe, nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi kuotat e shoqërisë nga asnjëri prej ortakëve tek palët e treta nëpërmjet (i) një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, (ii) një akti shkëmbimi (neni 757 i Kodit Civil), (iii) një kontributi në shoqëri të treta ose (iv) çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpersëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë se ortakëve të shoqërisë tek të tretë.
- 8.5 Kuotat e shoqërisë janë të transferueshme inter vivos, kundrejt pagesës, sipas procedurës së përcaktuar nga paragrafët në vijim të këtij neni, duke konsideruar ndalimin/ përashtimin nga transferimi sipas pikës 8.4 më sipër.
- 8.6 Ortaku që synon të transferojë të drejtën e pronësisë mbi kuotën që zotëron (në vijim "**Ortaku Shitës**"), duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim të gjithë ortakët e tjerë (në vijim "**Ortakët e tjerë**") nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrjeje (në vijim "**Njoftimi**") të dërguar në adresën përkatëse të ortakëve. Njoftimi duhet të përbajë çmimin e kalimit të kuotës.
- 8.7 Ortakët e tjerë do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar, me të njëjtin çmim sikurse të përcaktuar në Njoftim. Nëse cilido prej ortakëve të tjerë synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, duhet të njoftojë Ortakun Shitës me letër rekomande me njoftim marrjeje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes se Njoftimit. Në të kundërt, do të konsiderohet se është hequr dorë prej së drejtës së parablerjes.
- 8.8 Nëse më shumë se një prej Ortakëve të Tjerë ka ushtruar te drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të blihen prej tyre në përpjestim me kuotat përkatëse që ata zoterojnë në shoqëri, me të njëjtat kushte dhe afate të propozuara nga Ortaku Shitës.
- 8.9 Nëse asnjëri prej Ortakëve të Tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të sipershënuar, Ortaku Shitës do të jetë i lirë të shesë/ transferojë tek i treti kuotën e përcaktuar në Njoftim, i cili duhet të përbajë: (i) emrin e të tretit blerës, (ii) çmimin për transferimin e kuotës. Transferimi i kuotës së zotëruar nga ortaku

do të kryhet vetëm pas miratimit nga Asambleja. Miratimi nga Asambleja nuk do të vonohet apo pengohet pa shkaqe të arsyeshme, të cilat mund të lidhen vetëm me rregullsinë e transaksionit.

- 8.10** Me përjashtim të rastit kur me unanimitet ortakët vendosin ndryshe, ortakët nuk mund të vënë peng, barrë siguruese ose çfarëdolloj barre tjetër mbi kuotat e shoqërisë.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organii Vendimmarrës

- 9.1** Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2** Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, pavarësisht janë ose jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakort me këto vendime.
- 9.3** Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 9.4** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a)** Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori(-ët);
 - b)** Emëron dhe shkarkon administratorin(-ët) në përputhje me rregullat që përcaktohen në këtë Akt Themelimi dhe Statut;
 - c)** Emëron dhe shkarkon ekspertin(-ët) kontabël dhe/ose likujduesin(-ët) e Shoqërisë;
 - d)** Përcakton shpérblimin e administratorit(-ëve), ekspertëve kontabël dhe likujduesve;
 - e)** Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
 - f)** Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
 - g)** Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - h)** Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
 - i)** Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
 - j)** Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori apo prej Ortakëve zotërues të të paktën 5% të votave sipas legjislacionit në fuqi.
- 10.2** Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim me lajmërim marrjeje ose postë elektronike me lajmërim marrjeje. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet Ortakëve brenda 5 (pesë) ditëve para datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 10.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 10.4** Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.

10.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë/autorizim me shkrim, i cili do të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe mbledhje vijuese me të njëjtin rend dite. Administratori i Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

10.6 Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike të audiove dhe video-konferencës.

Përdorimi i mjeteve elektronike për t'u mundësuar Ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e Ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 11 Proçesi i Vendimmarrjes

11.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.

11.2 Në rastin e marries së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas pikës 11.5 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë 100% (njëqind përqind) të numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike.

11.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

11.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me 51% (pesëdhjetë e një përqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës, në lidhje me çështje për të cilat ligji dhe/ose ky Statut nuk kërkon një shumicë të cilësuar të përcaktuar në pikën 11.5 më poshtë.

11.5 Vendimet e mëposhtme do të konsiderohen Vendime Strategjike për veprimtarinë e Shoqërisë dhe do të janë të vlefshme vetëm nëse për to votojnë Pro Ortakët që veçmas ose bashkarisht përfaqësojnë **të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind)** të kapitalit themeltar të saj ose 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës:

- Ndryshimin e këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
- Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Shpërndarjen e fitimeve (dividenti) dhe mbulimin e humbjeve;
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorëve të Shoqërisë;
- Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë;
- Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërblimeve;
- Shitjen, dhurimin, dhënien me qira apo disponimi në çdo formë i pasurisë së paluajtëshme të shoqërisë;

11.6 Vendosjen peng ose kolateral të kuotave në Shoqëri si dhe vendosjen peng ose kolateral të çdo pasurie të shoqërisë;

11.7 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Largimi i Ortakut të Shoqërisë

- 12.1** Ortaku mund të largohet nga Shoqëria në rast se:
- i. Ortakët e tjerë apo Shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, me faj ose nga pakujdesia;
 - ii. Është penguar të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
 - iii. Shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme;
 - iv. Egzistojnë shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimësinë e ortakërisë në këtë shoqëri ose është shkelur parimi i mirëbesimit dhe i qëllimit për të cilin është formuar kjo ortakëri.
- 12.2** Për ushtrimin e të drejtës së largimit zbatohet Ligji 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Administratori thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pas komunikimit të njoftimit të largimit për të vendosur nëse ortakut do t'i likudohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
- 12.3** Për vlerësimin e çmimit të kuotës të ortakut të dorëhequr që duhet shlyer, do të merret parasysh vlera sipas kërkësës së tregut në shit-blerjen e kuotave në momentin e largimit të ortakut.

KAPITULLI IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 13

Administratori

- 13.1** Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj:
- **Z. Zaim BARDHI**, lindur më 25.04.1977, në Tropojë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr. Personal H704251830, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 13.2** Administratori i shoqërisë emërohet me një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 13.3** Administratori do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.
- 13.4** Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure të posaçme ose një autorizimi të posaçëm, një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkratë çdo dokument, kërkësë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 13.5** Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 13.6** Kur administratori i shoqërisë rezulton i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financier të kompanisë, atëherë Ortakët e shoqërisë vendosin lidhur me shpërblimin që do ti jepet atij në fund të vitit finanziar.
- 13.7** Për të asistuar Administratorin gjatë ushtrimit të detyrimeve të tij në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron 2 (dy) Zëvëndës Administratorë, të cilët do të zëvëndësojnë Administratorin (në rast mungese etj.), duke marr paraprakisht miratim nga ai me shkrim ose nëpërmjet mjeteve të tjera elektronike për kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve të caktuara.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

14.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisti dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- e) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KAPITULLI V

VITI FINANCIAR , BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 15

Viti finanziar

15.1 Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Ekspertët

16.1 Eksperti ka pér detyrë që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij pér rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

16.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollot periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU VI PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 17

Prishja dhe likuidim

17.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015.
- e) me vendim të gjykatës;

17.2 Në këtë rast Ortakët merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në ëdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

17.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

17.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Neni 18

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

18.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

20.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 21

Fitimi që shpërndahet

21.1 Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahej vendoset rast pas rasti nga Ortakët e shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.


Neni 22
Hyrja në fuqi

22.1 Ky statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët themelues të shoqërisë.

**ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

*** "LIRA CREDIT"Sh.p.k ***


FATLIND BARDHI



ZAIM BARDHI



ORGEST HABILAJ



FLORIAN NANAGJOKA

